



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0493

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Batisha Ibrahimimi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE Tretrek SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e mirëmbajtjes dhe avancimit të sistemit të prokurimit elektronik” me numër të prokurimit 201/26300-26-2774-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit, më 14/08/2026, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e “Tretrek” SH.P.K. me nr. 2026/0493, e datës 14/07/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e mirëmbajtjes dhe avancimit të sistemit të prokurimit elektronik”, me numër të prokurimit 201/26300-26-2774-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit.

2. Mbetet në fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Agjencia Qendrore e Prokurimit për aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e mirëmbajtjes dhe avancimit të sistemit të prokurimit elektronik”, me numër të prokurimit 201/26300-26-2774-2-1-1.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Tretrek” SH.P.K kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 28.04.2026 Agjencia Qendrore e Prokurimit, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e

mirëmbajtjes dhe avancimit të sistemit të prokurimit elektronik”, me numër të prokurimit 201/26300-26-2774-2-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 316,800.00 € €.

Me 29.06.2026, Autoriteti Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin mbi vendimin e AK (B58), ku është rekomanduar për kontratë OE “Komptel Energeniering”.

Me 03.07.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 07.07.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 14.07.2026, OE “Tretak SH.P.K”, ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0493, duke e atakuar Vendimin për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

AQP së bashku me ekspertet nga komisioni i vlerësimit (AK njësi e kërkesës) ka shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik Tretak SH.P.K. dhe vlerëson se pretendimet e OE janë të pa bazuara. Pretendimet e operatorit ekonomik nuk qëndrojnë, për arsye si ne vijim:

Lidhur me pretendimin ankimor/kerkesen: “7.2 së paku një nga projektet te ketë qenë zhvillim, zbatim apo mirëmbajtje e një Sistemi të Prokurimit Elektronik për Institucionet Publike apo sistem i ngjashëm me madhësinë dhe kompleksitetin e Sistemit të Prokurimit Elektronik (ku kerkohet siguri e larte e informacionit, ndervepruesmeri me sisteme te tjera te TI-se dhe ka patur perdorim te gjere G2G, G2B dhe G2C) gjate tri viteve te shkuara deri ne publikimin e ketij njoftimipër kontrate”. Për te cilin OE pretendon se është plotësuar, AK edhe me tutje vlerëson se kjo kërkesë nuk është plotësuar dhe se pretendimi ankimor i OE nuk qëndron. Sqarimet e dhëna rreth projektit "Furnizimi, Zhvillimi dhe Implementimi i Sistemit Elektronik të Avancuar për Deklarimin e Pasurisë dhe Menaxhimin e Rasteve” me qëllimin që ky projekt është sistem i ngjashëm me madhësinë dhe kompleksitetin e Sistemit të Prokurimit Elektronik (ku kerkohet siguri e larte e informacionit, ndervepruesmeri me sisteme te tjera te TLse dhe ka patur përdorim te gjere G2G, G2B dhe G2C), përfshirë një konfirmim me email nga ana e MK pas pyetjes se OE nuk ofron dëshmi se Sistemit Elektronik të Avancuar për Deklarimin e Pasurisë dhe Menaxhimin e Rasteve është një sistem i ngjashëm me sistemin e prokurimit elektronik, sidomos ne kompleksitetin e tij dhe nivelin dhe frekuencën e përdorimit. Për me shume, ne aspektin e niveiite te përdorimit, numrit te përdoruesve dhe frekuencën e përdorimit, ashtu siç

është specifikuar ne Termate Referencës, Sistemi i prokurimit elektronik ka rreth 3000 përdorues unik brenda 24 orëve, të cilët kryejnë me qindra mijë transaksione brenda ditës dhe në 365 ditë të vitit pandërprerë, derisa Sistemit Elektronik të Avancuar për Deklarimin e Pasurisë dhe Menaxhimin e Rasteve është një sistem ka përdorim të një numri të kufizuar të përdoruesve dhe në një periudhë të kufizuar brenda vitit. Prandaj ky pretendim ankimor i OE nuk qëndron. Lidhur me pretendimin ankimor/kërkesën: “Se paku një Analist Biznesi me përvojë të dëshmuar në fushën e prokurimit publik dhe prokurimeve elektronike, me njohuri të legjislacionit të prokurimit publik dhe përvojë në automatizimin e proceseve të punës në prokurim, si dhe me përvojë si Analist Biznesi / Menaxher Projekti në së paku tri sisteme ose projekte të teknologjisë informative, të implementuara në nivel organizatash apo institucionesh me numër të madh përdoruesish dhe përdorim të gjerë; Për të cilën OE pretendon se është plotësuar me propozimin e z. Besnik Hajdari, AI< edhe me tutje vlerëson se kjo kërkesë nuk është plotësuar dhe pretendimi i OE nuk qëndron. Pavarësisht pretendimit të OE dhe sqarimeve të ofruara, vlerësimi i AK se kjo kërkesë nuk është plotësuar bazohet në dokumentacionin e ofruar nga OE, ku dëshmitë për përvojën si Analist Biznesi ose Menaxher Kontrate janë me reference të OE ofertues dhe biznesit të vet ekspertit të propozuar, dhe për projekte për të cilat ende vlerësojmë që nuk janë projekte të teknologjisë informative, të implementuara në nivel organizatash apo institucionesh me numër të madh përdoruesish dhe përdorim të gjerë. Përndryshe, AK nuk ka kontestuar përvojën e z. Besnik Hajdari si punonjës brenda KRPP-se dhe gjithashtu certifikimin në prokurim publik, por që të dy dëshmitë nuk janë të mjaftueshme për të plotësuar profilin e një analisti të biznesit ose menaxherit të kontratës edhe si ekspert me përvojë të dëshmuar në fushën e prokurimit publik dhe prokurimeve elektronike, me njohuri të legjislacionit të prokurimit publik dhe përvojë në automatizimin e proceseve të punës në prokurim. Prandaj ky pretendim ankimor i OE nuk qëndron. **Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Tretak SH.P.K”, janë parashtruar si në vijim:**

Në B58 - Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues dt. 29.06.2026, në si ofertues i kësaj procedure prokurimit eliminohemi për arsyet si në vijim:

Për Kërkesën 1 në ofertën e tuaj janë paraqitur një listë të kontratave të realizuara. Megjithatë, nga krahasimi dhe vlerësimi i të dhënave të paraqitura në kuadër të këtij dokumenti vlerësohet se dokument përmban se paku tre projekte të ngjashme apo projekte që kanë të bëjnë me sisteme të teknologjisë informative por asnjëri nga projektet nuk mund të konsiderohet sistem i ngjashëm me madhësinë dhe kompleksitetin e Sistemit të Prokurimit Elektronik (ku kërkohet siguri e lartë e informacionit, nderveprueshmëri me sisteme të tjera të TI-se dhe që ka pasur përdorim të gjere G2G, G2B dhe G2C). Kjo për faktin se asnjëri nga projektet nuk mund të krahasohet me frekuencën dhe volumin e përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik.

Ky konstatim nga AK-ja është bërë pa kërkuar asnjë sqarim apo dokument shtesë nga ne, ndonëse një veprim i tillë ka qenë plotësisht i mundur sipas nenit 59 paragrafi 2 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik. Mosshfrytëzimi i këtij mekanizmi dhe nxjerrja e përfundimeve pa verifikuar faktet bie ndesh me dispozitat e nenit 7 të LPP-së. Në rast se AK-ja kishte paqartësi lidhur me karakteristikat teknike apo kompleksitetin e projekteve të paraqitura, mund të kërkonte sqarime për të vërtetuar gjendjen faktike, e jo të nxirrte përfundime vetëm mbi bazën e një interpretimi të dokumenteve të dorëzuara.

Në veçanti, projekti "Furnizimi, Zhvillimi dhe Implementimi i Sistemit Elektronik të Avancuar për Deklarimin e Pasurisë dhe Menaxhimin e Rasteve" përmbush karakteristika të avancuara teknike dhe funksionale, të cilat korrespondojnë me kërkesat e përcaktuara në DT. Për të eliminuar çdo paqartësi lidhur me këtë projekt, po bashkëngjisim **konfirmimin zyrtar të Menaxherit të Kontratës nga AK** përkatës, **në të cilin konfirmohet qartë se sistemi përmban siguri të lartë e informacionit, nderveprueshmeri me sisteme të tjera të TI-se dhe ka pasur përdorim të gjere G2G, G2B dhe G2C.** Rrjedhimisht, refuzimi i këtij projekti pa kërkuar paraprakisht sqarime sipas paragrafit 2 të nenit 59 të LPP-së përbën një vlerësim të paplotë të fakteve dhe bie ndesh me dispozitat ligjore të LPP-së, pasi që AK nuk ka shfrytëzuar mekanizmin ligjor për të verifikuar nëse projekti i paraqitur përmbushte kërkesat e dosjes së tenderit.

Provë: Konfirmimi zyrtar nga Menaxheri i Kontratës, i përcjellë përmes emailit.

Andaj kërkesa e përmendur në DT "Furnizimi, Zhvillimi dhe Implementimi i Sistemit Elektronik të Avancuar për Deklarimin e Pasurisë dhe Menaxhimin e Rasteve" përmes references dhe konfirmimit të pranuar nga menaxheri i kontratës nga AK, konstatohet se "Kërkesa 1 Ofertuesi gjatë tri viteve të fundit duhet të ketë të implementuar suksesshem

1.1. projekte të ngjashme (zhvillim, implementim ose mirëmbajtje) ku prej tyre se paku tri projekte të sistemeve të teknologjisë informative, dhe

1.2. së paku një nga projektet të ketë qenë zhvillim, zbatim apo mirëmbajtje e një Sistemi të Prokurimit Elektronik për Institucionet Publike apo sistem i ngjashëm me madhësinë dhe kompleksitetin e Sistemit të Prokurimit Elektronik (ku kerkohet siguri e larte e informacionit, nderveprueshmeri me sisteme të tjera të TI-se dhe ka patur perdorim të gjere G2G, G2B dhe G2C) gjate tri viteve të shkuara deri ne publikimin e këtij njoftimi për kontrate është plotësuar.

Pretendimet e lartpërmendura së bashku me prova janë paraqitur në kërkesë për rishqyrtim, mirëpo me datë **07.07.2026**, në vendimin e AK-së mbi kërkesën për rishqyrtim arsyetimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktues është si në vijim:

Nga arsyetimi i mësipërm rezulton qartë se AK-ja nuk e ka bazuar vlerësimin në kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe Dosjen e Tenderit, **por në kritere të reja të vendosura gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.** Një qasje e tillë është gjithashtu në kundërshtim me nenin 27, 56 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, sipas të cilit ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve duhet të bëhet vetëm mbi bazën e kriterëve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk ka kompetencë që gjatë fazës së vlerësimit të krijojë ose të aplikojë standarde shtesë që nuk janë bërë pjesë e dokumenteve të tenderit.

Konkretisht, ndonëse AK pranon ekzistencën e konfirmimit zyrtar të Menaxherit të Kontratës, në të cilin konfirmohen shprehimisht karakteristikat teknike dhe funksionale të projektit, përfshirë sigurinë e lartë të informacionit, nderveprueshmërinë me sisteme të tjera të TI-së, si dhe përdorimin G2G, G2B dhe G2C, AK-ja nuk jep asnjë arsyetim faktik, teknik apo juridik për ti kundërshtuar këto fakte dhe as nuk paraqet ndonjë provë që do të vinte në dyshim vërtetësinë e konfirmimit të lëshuar nga Menaxheri i Kontratës.

Përkundrazi, nga vetë arsyetimi i AK-së rezulton se eliminimi i ofertës sonë është mbështetur në elemente si **numri i përdoruesve, frekuenca e përdorimit dhe volumi i transaksioneve** të Sistemit të Prokurimit Elektronik. **Mirëpo, as Njoftimi për Kontratë dhe as Dosja e Tenderit nuk përmbajnë ndonjë kërkesë apo kriter kualifikimi që përcakton numër minimal përdoruesish, frekuencë minimale të përdorimit, volum transaksionesh, apo ndonjë standard tjetër sasior të këtij lloji.**

Kërkesa është shumë e qartë ku kërkon vetëm që ofertuesi të ketë realizuar së paku një projekt të zhvillimit, implementimit ose mirëmbajtjes së një Sistemi të Prokurimit Elektronik për Institucionet Publike ose **një sistemi të ngjashëm me madhësinë dhe kompleksitetin e tij,** duke specifikuar si karakteristika **sigurinë e lartë të informacionit, ndërveprueshmërinë me sisteme të tjera të TI-së dhe përdorimin G2G, G2B dhe G2C, e jo kritere që lidhen me numrin e përdoruesve apo volumin e përdorimit.** Për më tepër, një interpretim i tillë bie në kundërshtim edhe me nenin 28 të LPP-së, i cili kërkon që specifikimet teknike dhe kërkesat e kontratës të jenë të përcaktuara paraprakisht në dokumentet e tenderit dhe të jenë të qarta për të gjithë operatorët ekonomikë. Duke shtuar kritere të reja gjatë fazës së vlerësimit, AK ka ndryshuar në mënyrë të njëanshme përmbajtjen e kërkesave të DT.

Rrjedhimisht, AK-ja ka zgjeruar dhe modifikuar kriteret e kualifikimit pas publikimit të Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit në platformën e E-Prokurimit, duke vendosur standarde shtesë gjatë vlerësimit të ofertave që nuk kanë qenë dhe nuk janë pjesë e dokumenteve të tenderit dhe për të cilat OE-të nuk kanë qenë të njoftuar paraprakisht. Në përputhje me dispozitat ligjore të Prokurimit Publik, vlerësimi i ofertave duhet të kryhet ekskluzivisht mbi bazën e kritereve të publikuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, ndërsa jo mbi kritere të reja të krijuara gjatë procesit të vlerësimit duke vepruar në kundërshtim me nenin 17 paragrafi 17.12 të Rregullores për Prokurimin Publik Nr. 001/2022 dhe në kundërshtim me nenin 7, 27 dhe 59 të LPP-së.

2. Në B58 - Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues dt. 29.06.2026, ne si ofertues i kësaj procedure prokurimit eliminohe mi për arsyjet si në vijim:

Për Kërkesën 2 nga krahasimi dhe vlerësimi i dokumenteve të ofertës lidhur me kapacitetet njerëzore apo stafin e propozuar për pikat: 1, 2, 3 dhe 4 evidentohet se për stafin/ekspertin e propozuar si Analist Biznesi nuk dëshmohe t përvojë e mjaftueshme në fushën e prokurimit publik dhe prokurimeve elektronike, me njohuri të legjislacionit të prokurimit publik dhe përvojë në automatizimin e proceseve të punës në prokurim dhe sidomos në Menaxher Projekti në së paku tri sisteme ose projekte të teknologjisë informative, të implementuara në nivel organizatash apo institucione sh me numër të madh përdoruesish dhe përdorim të gjerë.

Konstatimi i AK-së: “Për Kërkesën 2 nga krahasimi dhe vlerësimi i dokumenteve të ofertës lidhur me kapacitetet njerëzore apo stafin e propozuar për pikat: 1, 2, 3 dhe 4 evidentohet se për stafin/ekspertin e propozuar si Analist Biznesi nuk dëshmohe t përvojë e mjaftueshme në fushën e prokurimit publik dhe prokurimeve elektronike, me njohuri të legjislacionit të prokurimit publik dhe përvojë në automatizimin e proceseve të punës në prokurim” është në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar me rastin e ofertës dhe bie ndesh edhe me nenin 56 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, pasi komisioni vlerësues nuk ka bërë një shqyrtim objektiv të të gjitha provave të dorëzuara, por ka nxjerrë përfundime pa analizuar dokumentacionin në tërësinë e tij.

Së pari, z. **Besnik Hajdari** posedon përvojë shumëvjeçare në **Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP)**, ku ka qenë i angazhuar nga viti **2010 deri në vitin 2018**, fakt i cili është dëshmuar edhe përmes **vërtetimit të marrëdhënies së punës nr. 21/2023, të datës 17.03.2023**, të lëshuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

Gjatë kësaj periudhe ai ka ushtruar funksionin e **Ekspertit të Teknologjisë Informative**, duke qenë i përfshirë drejtpërdrejt në fushën e **prokurimit elektronik (e-Prokurimi)**, zhvillimin dhe mbështetjen e proceseve elektronike të prokurimit, si dhe në automatizimin e proceseve të punës në prokurim. Vetë fakti që eksperti ka qenë i angazhuar për vite me radhë në KRPP, institucion përgjegjës për zhvillimin dhe administrimin e sistemit të prokurimit elektronik në Republikën e Kosovës, e bën të pabazuar konstatimin se ai nuk posedon përvojë në prokurim elektronik apo njohuri të legjislacionit të prokurimit publik.

Provë: vërtetimi i marrëdhënies së punës

Përveç kësaj, në CV-në e dorëzuar janë paraqitur qartë edhe angazhimet e tij profesionale në fushën e prokurimit elektronik, ndër të cilat:

- **Ekspert me procedura të prokurimit për shërbime të veçanta në fushat e Teknologjisë Informative, digjitalizimit dhe inovacionit në Zyrën e Kryeministrit (2024);**
- **Trajner dhe Specialist i Prokurimit Elektronik në kuadër të KRPP & USAID (2016–2018);**
- **Trajner i Prokurimit Publik në kuadër të IKAP & USAID (2016–2017).**

Këto angazhime dëshmojnë qartë se eksperti i propozuar jo vetëm që ka përvojë shumëvjeçare në fushën e prokurimit publik dhe prokurimit elektronik, por ka qenë edhe i angazhuar në trajnimet profesionale dhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale në këtë fushë.

Po ashtu, pretendimi i AK se eksperti nuk posedon **njohuri të legjislacionit të prokurimit publik** është po ashtu i pabazuar, pasi në ofertë është dorëzuar dëshmia se z. Besnik Hajdari është **i certifikuar me Certifikatën e Avancuar Profesionale të Prokurimit Publik**, të lëshuar në vitin **2020**, certifikim ky i cili lëshohet vetëm pas përmbushjes së kërkesave profesionale dhe njohjes së legjislacionit të prokurimit publik. Përveç kësaj, eksperti i propozuar posedon edhe certifikime dhe trajnime të tjera profesionale në fushën e prokurimit elektronik, të cilat janë dorëzuar si pjesë e ofertës dhe dëshmojnë kompetencat e tij profesionale në këtë fushë.

Provë: Certifikata e avancuar profesionale të prokurimit publik Rrjedhimisht, konstatimi i Autoritetit Kontraktues se z. Besnik Hajdari nuk dëshmon përvojë në fushën e prokurimit publik, prokurimit elektronik, automatizimin e proceseve të punës në prokurim dhe njohuri të legjislacionit të prokurimit publik **është në kundërshtim të plotë** me dokumentacionin e dorëzuar në ofertë dhe në kundërshtim me nenin 7 dhe 59 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e AK-së “*dhe sidomos ne Menaxher Projekti në së paku tri sisteme ose projekte të teknologjisë informative, të implementuara në nivel organizatash apo institucionesh me numër të madh përdoruesish dhe përdorim të gjerë.*” theksojmë se edhe ky konstatim nuk mbështetet në dokumentacionin e dorëzuar në ofertë.

Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë një vlerësim të plotë sepse një vlerësim i tillë nuk është në përputhje me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili obligon autoritetin kontraktues të sigurojë trajtim të barabartë, proporcionalitet dhe vlerësim objektiv të operatorëve ekonomikë dhe objektiv të dokumentacioni, pasi nuk ka marrë fare në konsideratë **referencën e lëshuara nga Tretëk SH.P.K.** e cila është dorëzuar si pjesë e ofertës dhe në të cilat përshkruhen qartë projektet në të cilat z. Besnik Hajdari ka qenë i angazhuar në cilësinë e **Analistit të Biznesit dhe Menaxherit të Projekteve**.

Si mund të arsyetohet AK, se Menaxheri i Projektit nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit për përvojë në së paku tri sisteme apo projekte të teknologjisë informative, të implementuara në nivel organizatash apo institucionesh me numër të madh përdoruesish dhe përdorim të gjerë, kur nga referencat e dorëzuara nga TRETEK, rezulton qartë se kandidati i propozuar si Analist ka menaxhuar projekte të implementuara dhe në përdorim aktiv nga një numër i konsiderueshëm përdoruesish, konkretisht:

1. iPacienti.com (sistem në përdorim në mbi 117 klinika në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Shqipëri dhe Itali, me mbi 479,092 pacientë të regjistruar)
2. Digitalisation of Clinical, Laboratory and Financial Processes (sistem në përdorim nga mbi 10,000 pacientë aktivë të klinikës nga e gjithë Kosova)
3. Sistem B2B për Menaxhimin Online të Porosive; (sistem në përdorim nga mbi 1,228 biznese farmaceutike të regjistruara, të cilat e përdorin platformën 24/7 në gjithë Kosovën).
4. Mirëmbajtja e Softuerit për menaxhimin e auditimit – SITA (sistem institucional në përdorim nga mbi 140 auditorë dhe staf administrativ të ZKA-së;)
5. Development and Implementation of Pathfinder - Global AI-Powered Personal Insight Platform (platformë në përdorim nga mbi 8,700 përdorues aktivë në nivel global).

Përkundër këtyre projekteve, AK-ja nuk ka bërë një vlerësim individual të asnjërës prej referencave, nuk ka identifikuar se cili projekt, cili element apo cila pjesë e dokumentacionit nuk e përmbush kërkesën e DT dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim faktik apo juridik për refuzimin e tyre. **Në vend të kësaj, është mjaftuar me një konstatim të përgjithshëm se ekspertit nuk e plotëson kriterin, pa analizuar përmbajtjen e dokumentacionit të dorëzuar.** Një arsyetim i tillë nuk përbën një vlerësim objektiv dhe të bazuar në prova, siç kërkohet nga Ligji për Prokurimin Publik dhe Rregullorja për Prokurimin Publik.

Nga sa më sipër rezulton se projektet e paraqitura në referencë, dëshmojnë qartë përvojën e Menaxherit të Projektit në sisteme të implementuara dhe me përdorim të gjerë. Për më tepër, dosja e tenderit **nuk ka përcaktuar** asnjë prag minimal apo numër konkret të përdoruesve që duhet të ketë një sistem për tu konsideruar si sistem me "numër të madh përdoruesish" apo "përdorim të gjerë". Për rrjedhojë, çdo vlerësim i bazuar në një kriter të tillë numerik paraqet interpretim subjektiv dhe shtim të një kriteri që nuk është paraparë në dokumentet e tenderit.

Një veprim i tillë është në kundërshtim edhe me nenin 40 të Rregullores për Prokurimin Publik dhe nenin 59 të LPP-së, i cili obligon komisionin vlerësues që gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve të analizojë në mënyrë objektive të gjitha dokumentet dhe provat e paraqitura nga operatorët ekonomikë dhe të japë arsyetim të plotë për çdo konstatim që çon në eliminimin e ofertës. Në rastin konkret, nuk është bërë asnjë analizë individuale e referencave të

dorëzuara nga TRETEK.

Në rast se AK-ja kishte paqartësi lidhur me rolin e ekspertit në projektet e referuara, madhësinë e sistemeve apo nivelin e implementimit të tyre, AK kishte në dispozicion mekanizmin ligjor e paraparë me nenin 59 paragrafi 2 të apo nenin 72 Ligjit për Prokurimin Publik për të kërkuar sqarime shtesë. Në vend të kësaj, Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë përfundime mbi baza supozuese, pa shfrytëzuar mundësinë ligjore për të verifikuar faktet e paraqitura në ofertë. Si rrjedhojë, vendimi për eliminimin e ofertës sonë është rezultat i një vlerësimi të paplotë dhe joobjektiv të dokumentacionit dhe provave të dorëzuara.

Pretendimet e lartpërmendura së bashku me prova janë paraqitur në kërkesë për rishqyrtim, mirëpo me datë **07.07.2026**, në vendimin e AK-së mbi kërkesën për rishqyrtim arsyetimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktues është si në vijim:

Për më tepër, edhe në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim, AK-ja nuk ka arritur të japë një arsyetim konkret, të plotë dhe të bazuar në prova për mospranimin e referencave të dorëzuara nga Tretak. AK është mjaftuar me konstatimin e përgjithshëm se projektet e referuara "nuk janë projekte të teknologjisë informative, të implementuara në nivel organizatash apo institucionesh me numër të madh përdoruesish dhe përdorim të gjerë", pa shpjeguar se cili element i secilës referencë nuk e përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit.

Në asnjë pjesë të vendimit nuk analizohet individualisht projekti **iPacienti.com, Digitalisation of Clinical, Laboratory and Financial Processes, Sistemi B2B për Menaxhimin Online të Porosive, Mirëmbajtja e Softuerit për Menaxhimin e Auditimit – SITA dhe Pathfinder – Global AI Powered Personal Insight Platform.**

Në mungesë të një analize të tillë, është e pamundur të kuptohet mbi cilat fakte apo prova AK ka mbështetur përfundimin e saj se këto projekte nuk plotësojnë kriterin e përcaktuar në Dosjen e Tenderit. Një vendim administrativ nuk mund të mbështetet në konstatime deklarative, por duhet të përmbajë një analizë konkrete të secilës provë të dorëzuar dhe arsyet pse ajo pranohet ose refuzohet.

Për më tepër, Dosja e Tenderit nuk ka përcaktuar asnjë kriter, prag minimal apo metodologji vlerësimi mbi bazën e së cilës një projekt do të konsiderohej ose jo si projekt i teknologjisë informative i implementuar në organizata apo institucione me numër të madh përdoruesish dhe përdorim të gjerë. Për rrjedhojë, nëse Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se projektet e paraqitura nuk e plotësojnë këtë kërkesë, ai ka pasur detyrimin ligjor të arsyetojë në mënyrë konkrete dhe të argumentuar pse secili prej tyre nuk e përmbush kriterin, duke iu referuar dokumentacionit të dorëzuar. Mosdhënia e një arsyetimi të tillë përbën shkelje të parimit të transparencës, të trajtimit të barabartë dhe të vlerësimit objektiv të ofertave, të garantuara me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Për më tepër, vetë Autoriteti Kontraktues në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim pranon se "AK nuk ka kontestuar përvojën e z. Besnik Hajdari si punonjës brenda KRPP-së dhe gjithashtu certifikimin në prokurim publik", duke pranuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ekzistencën e përvojës së tij në fushën e prokurimit publik dhe prokurimit elektronik. Megjithatë, pa dhënë ndonjë analizë shtesë dhe pa identifikuar ndonjë mangësi konkrete në dokumentacion, AK arrin në përfundimin se këto dëshmi "nuk janë të mjaftueshme".

Një arsyetim i tillë është kontradiktor, pasi nuk mbështetet në asnjë kriter të përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe nuk shpjegon objektivisht se cilat elemente të kërkesës mbeten të paplotësuara. Për pasojë, vendimi nuk mbështetet në një vlerësim të dokumentacionit të ofertës, por në një vlerësim subjektiv dhe të paarsyetuar, në kundërshtim me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Për pasojë, vendimi i Autoritetit Kontraktues është nxjerrë në kundërshtim me nenet 7, 27, 28, 56, 59 dhe 72 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, si dhe me nenet 4, 17, 19 dhe 40 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, për shkak se oferta jonë nuk është vlerësuar mbi bazën e kriterëve të publikuara në Dosjen e Tenderit, nuk janë kërkuar sqarime kur ka pasur paqartësi, nuk është bërë analizë objektive e provave të dorëzuara dhe janë aplikuar kritere shtesë që nuk kanë qenë pjesë e dokumenteve të tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha shkeljet e lartpërmendura, kërkojmë nga OSHP-ja që: I. Ta shpallë ankesën tonë të bazuar dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim, duke obliguar Autoritetin Kontraktues që, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe dispozitat përkatëse të Rregullores për Prokurim Publik, të anulojë vendimin e mëparshëm dhe të ftojë Tretëk SH.P.K. për nënshkrimin e kontratës si operatori ekonomik me ofertën më të përgjegjshme.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Tretëk SH.P.K.”, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0493 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigjeje ndaj pretendimit 1: OE ankues pretendon se eliminimi ynë nga AK-ja është bërë pa kërkuar asnjë sqarim apo dokument shtesë nga ne, ndonëse një veprim i tillë ka qenë plotësisht i mundur sipas nenit 59 paragrafi 2 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik. Mosshfrytëzimi i këtij mekanizmi dhe nxjerrja e përfundimeve pa verifikuar faktet bie ndesh me dispozitat e nenit 7 të LPP-së. Në rast se AK-ja kishte paqartësi lidhur me karakteristikat teknike apo kompleksitetin e projekteve të paraqitura, mund të kërkonte sqarime për të vërtetuar gjendjen faktike, e jo të nxirrte përfundime vetëm mbi bazën e një interpretimi të dokumenteve të dorëzuara.

Eksperti shqyrtues bazuar në Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve paragrafi 2 I këtij neni sqaron se:

2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahësimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohej ose pranohet nga autoriteti kontraktues ose të ofrohet nga një tenderues.

Andaj eksperti shqyrtues sqaron se ky neni i jep Autoritetit Kontraktues një kompetencë diskrecionale, e jo një detyrim, për të kërkuar sqarime me shkrim nga tenderuesit. Për rrjedhojë, fakti që Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar sqarime nuk përbën, në vetvete, shkelje të këtij neni, përderisa ai ka vlerësuar se sqarimet nuk ishin të nevojshme për ekzaminimin, vlerësimin ose krahasimin e tenderëve, dhe si i tillë ky pretendim nuk qëndron.

Përgjigjeje ndaj pretendimit 2: Pretendimi tjetër i OE ankues është se, AK-ja ka zgjeruar dhe modifikuar kriteret e kualifikimit pas publikimit të Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit në platformën e E-Prokurimit, duke vendosur standarde shtesë gjatë vlerësimit të ofertave që nuk kanë qenë dhe nuk janë pjesë e dokumenteve të tenderit dhe për të cilat OE-të nuk kanë qenë të njoftuar paraprakisht. Në përputhje me dispozitat ligjore të Prokurimit Publik, vlerësimi i ofertave duhet të kryhet ekskluzivisht mbi bazën e kriterëve të publikuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, ndërsa jo mbi kritere të reja të krijuara gjatë procesit të vlerësimit duke vepruar në kundërshtim me nenin 17 paragrafi 17.12 të Rregullores për Prokurimin Publik Nr. 001/2022 dhe në kundërshtim me nenin 7, 27 dhe 59 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues se Autoriteti Kontraktues ka zgjeruar dhe modifikuar kriteret e kualifikimit gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, eksperti shqyrtues fillimisht ka analizuar përmbajtjen e kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit për kapacitetin teknik dhe profesional:

Eksperti shqyrtues, bazuar në kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe duke u mbështetur në mendimin e ekspertit teknik, vlerëson se nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se shprehja "sistem i ngjashëm me madhësinë dhe kompleksitetin e Sistemit të Prokurimit Elektronik ku kërkohet siguri e lartë e informacionit, ndërveprueshmëri me sisteme të tjera të TI-së dhe ka pasur përdorim të gjerë G2G, G2B dhe G2C)" ka qenë pjesë e kriterëve të kapacitetit teknik dhe profesional të publikuara në Dosjen e Tenderit. Në këtë drejtim, eksperti teknik ka vlerësuar se shprehja "përdorim i gjerë G2G, G2B dhe G2C" nënkupton jo vetëm ekzistencën e ndërveprueshmërisë teknike, por edhe një shtrirje dhe vëllim real të përdorimit të sistemit, si elemente që dëshmojnë madhësinë dhe kompleksitetin e projektit. Për rrjedhojë, vlerësohet se Autoriteti Kontraktues nuk ka modifikuar apo zgjeruar kriteret e kualifikimit gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, por ka zbatuar kriterin e publikuar paraprakisht në Dosjen e Tenderit, Andaj eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor nuk qëndron.

Në vazhdim paraqesim mendimin e ekspertit Teknik lidhur me ankesën nga OE "Tretek" SH.P.K. nr. 0493/26

Eksperti teknik, pas administrimit të dokumentacionit lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues "Tretek" SH.P.K. kundrejt kriterëve të kapacitetit teknik dhe profesional (Kërkesa 1 dhe Kërkesa 2, pika III.2.4) të vendosura në Dosjen e Tenderit, për aktivitetin e prokurimit Nr. 26300-26-2774-2-1-1 "Shërbimet e mirëmbajtjes dhe avancimit të sistemit të prokurimit elektronik", lidhur me vendimin e AK-së për eliminimin e ofertës së OE ankues dhe rekomandimin për shpërblim me kontratë të OE "Komtel Project Engineering" SH.P.K., mendon:

Pretendimi ankimor 1: OE ankues lidhur me këtë çështje pretendon se projekti i referuar "Furnizimi, Zhvillimi dhe Implementimi i Sistemit Elektronik të Avancuar për Deklarimin e Pasurisë dhe Menaxhimin e Rasteve" përmbush Kërkesën 1.2 të DT-së si "sistem i ngjashëm me madhësinë dhe kompleksitetin" e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE), dhe se AK e ka

refuzuar këtë projekt pa kundërshtuar me fakte konkrete konfirmimin zyrtar të Menaxherit të Kontratës.

Eksperti teknik sqaron se DT (III.2.4, Kërkesa 1.2) kërkon shprehimisht: "...së paku një nga projektet të ketë qenë zhvillim, zbatim apo mirëmbajtje e një Sistemi të Prokurimit Elektronik për Institucionet Publike apo sistem i ngjashëm me madhësinë dhe kompleksitetin e Sistemit të Prokurimit Elektronik (ku kërkohet siguri e lartë e informacionit, ndërveprueshmëri me sisteme të tjera të TI-së dhe ka pasur përdorim të gjerë G2G, G2B dhe G2C)..."

Nga shqyrtimi i dokumentacionit (konfirmimi zyrtar i Menaxherit të Kontratës, i dorëzuar si provë nga OE), konstatohet se projekti i referuar plotëson elementet arkitekturore/cilësore të përmendura në kllapa (siguri e lartë e informacionit, ndërveprueshmëri me sisteme të tjera të TI-së). Megjithatë, këto elemente janë shpjegim plotësues, jo zëvendësues, i kriterit kryesor "madhësi dhe kompleksitet". Vetë togfjalëshi "përdorim i gjerë G2G, G2B dhe G2C" nënkupton në mënyrë të natyrshme edhe vëllim dhe shtrirje reale përdorimi, jo thjesht aftësi teknike ndërveprimi.

Nga krahasimi funksional, një sistem i deklaramit të pasurisë operon si deklaram periodik (vjetor) nga një grup i kufizuar deklaruesish, i shqyrtuar nga një organ i kufizuar mbikëqyrës, profil operacional dukshëm i ndryshëm nga një platformë e-prokurimi që përpunon vazhdimisht transaksione në kohë reale, me mijëra përdorues aktivë çdo ditë, gjatë gjithë vitit (SPE: 54,000 përdorues të regjistruar, 3,500 përdorues unikë aktivë/ditë, sipas Aneksit 1 të DT-së). Kjo dallueshmëri në vëllim dhe frekuencë përdorimi është element objektiv, i vërtetueshëm nga vetë natyra funksionale e dy sistemeve, jo interpretim arbitrar apo kriter i shpikur nga AK.

Prandaj, nga këndvështrimi teknik-funksional, eksperti teknik mendon se konstatimi i AK-së — se projekti i referuar nuk është "i ngjashëm me madhësinë" e SPE-së, pavarësisht plotësimit të elementeve të sigurisë/ndërveprueshmërisë — është teknikisht i mbrojtshëm, dhe pretendimi ankimor i OE në këtë pjesë nuk është i bazuar.

Pretendimi ankimor 2: OE ankues lidhur me këtë çështje pretendon se eksperti i propozuar si Analist Biznesi, z. Besnik Hajdari, dëshmon përvojë të mjaftueshme në fushën e prokurimit publik dhe prokurimeve elektronike (angazhim në KRPP 2010–2018, certifikatë e avancuar profesionale e prokurimit publik 2020), ndërsa AK e ka vlerësuar këtë përvojë "të pamjaftueshme" pa identifikuar mangësi konkrete.

Eksperti teknik sqaron se DT (Kërkesa 2, teksti i korrigjuar përmes B54) kërkon shprehimisht: "...Analist Biznesi me përvojë të dëshmuar në fushën e prokurimit publik dhe prokurimeve elektronike, me njohuri të legjislacionit të prokurimit publik dhe përvojë në automatizimin e proceseve të punës në prokurim..."

Nga shqyrtimi i dokumentacionit (vërtetimi i marrëdhënies së punës nr. 21/2023 i lëshuar nga KRPP, certifikata e avancuar profesionale e prokurimit publik e vitit 2020, CV-ja me angazhime si Ekspert i Teknologjisë Informative në KRPP dhe trajner në kuadër të KRPP&USAID/IKAP&USAID), konstatohet se dokumentacioni i dorëzuar mbulon në mënyrë kumulative të katër elementet e kërkuara nga teksti i Kërkesës 2: (i) përvojë në fushën e prokurimit publik – e dëshmuar përmes angazhimit shumëvjeçar në KRPP (2010–2018); (ii) përvojë në prokurimet elektronike e dëshmuar përmes funksionit të ekspertit të teknologjisë informative brenda po të njëjtit institucion, përgjegjës direkt për sistemin e e-prokurimit; (iii) njohuri të legjislacionit të prokurimit publik e dëshmuar përmes certifikatës së avancuar

profesionale (2020), certifikim që sipas natyrës së vet lëshohet vetëm pas verifikimit të njohurive ligjore në fushë; dhe (iv) përvojë në automatizimin e proceseve të punës në prokurim e dëshmuar përmes angazhimeve si trajner/specialist i prokurimit elektronik në kuadër të KRPP&USAID dhe IKAP&USAID.

Kjo strukturë provash — ku secili element i kërkesës gjen mbështetje në një dokument apo angazhim specifik, të verifikueshëm dhe të lëshuar nga institucione të treta (jo vetëdeklarime të OE-së) — përbën, nga këndvështrimi teknik, një bazë të plotë për të konsideruar profilin e ekspertit si të përshtatshëm ndaj kërkesës.

Vendimi i AK-së mbi kërkesën për rishqyrtim pranon shprehimisht se "AK nuk ka kontestuar përvojën e z. Besnik Hajdari... dhe gjithashtu certifikimin në prokurim publik", por konkludon se këto dëshmi "nuk janë të mjaftueshme". Ky vlerësim trajton tërësinë e provave si të pamjaftueshme pa e ndarë apo diferencuar cilin prej katër elementeve e konsideron të paplotësuar. Prandaj, eksperti teknik mendon se pretendimi ankimor i OE në këtë pjesë është i bazuar.

Pretendimi ankimor 3: OE ankues lidhur me këtë çështje pretendon se AK nuk ka vlerësuar individualisht asnjërën nga pesë referencat e paraqitura si dëshmi për përvojën e z. Hajdari si Menaxher Projekti (iPacienti.com, Digitalisation of Clinical/Laboratory/Financial Processes, Sistemi B2B për Menaxhimin e Porosive, SITA, Pathfinder), dhe se dosja e tenderit nuk përcakton prag minimal numrik të përdoruesve për këtë kriter.

Eksperti teknik sqaron se DT (Kërkesa 2) kërkon "...përvojë si Analist Biznesi/Menaxher Projekti në së paku tri sisteme ose projekte të teknologjisë informative, të implementuara në nivel organizatash apo institucionesh me numër të madh përdoruesish dhe përdorim të gjerë", pa përcaktuar prag numerik konkret për të cilin një sistem konsiderohet me "numër të madh përdoruesish".

Eksperti teknik, duke i analizuar pesë referencat individualisht kundrejt këtij teksti, konstaton si vijon:

- iPacienti.com – sistem në përdorim aktiv në mbi 117 klinika, të shtrira në katër vende (Kosovë, Maqedoni e Veriut, Shqipëri, Itali), me mbi 479,092 pacientë të regjistruar. Ky është qartazi sistem TI i implementuar në nivel institucionesh të shumëfishta, me numër përdoruesish që e kalon ndjeshëm çdo lexim të arsyeshëm të togfjalëshit "numër i madh".
- Digitalisation of Clinical, Laboratory and Financial Processes – sistem në përdorim nga mbi 10,000 pacientë aktivë të klinikës, me shtrirje në të gjithë Kosovën. Përbush kërkesën si sistem institucional me shtrirje kombëtare.
- Sistemi B2B për Menaxhimin Online të Porosive – sistem në përdorim nga mbi 1,228 biznese farmaceutike të regjistruara, që e përdorin platformën 24/7 në të gjithë Kosovën. Ky profil operacional (shumë subjekte biznesi, funksionim i vazhdueshëm 24/7) është, në natyrën e vet funksionale, drejtpërdrejt i krahasueshëm me profilin e SPE-së si platformë G2B me qasje të vazhdueshme.
- Mirëmbajtja e Softuerit për Menaxhimin e Auditimit – SITA – sistem institucional (Zyra Kombëtare e Auditimit) në përdorim nga mbi 140 auditorë dhe staf administrativ; edhe pse numri absolut i përdoruesve është më i vogël se te referencat e tjera, sistemi operon në nivel

institucioni qeveritar (G2G), duke plotësuar kështu elementin "nivel organizatash apo institucionesh".

- Development and Implementation of Pathfinder – platformë me mbi 8,700 përdorues aktivë në shkallë globale, duke dëshmuar aftësinë e ekspertit për të menaxhuar projekte TI me shtrirje ndërkombëtare dhe volum të konsiderueshëm përdoruesish.

Duke i vlerësuar këto pesë projekte së bashku (jo në mënyrë të izoluar, siç e kërkon vetë natyra kumulative e kriterit — "së paku tri sisteme"), rezulton se OE ka dëshmuar përvojë të përsëritur, jo të rastësishme, në zhvillimin/menaxhimin e sistemeve TI me shtrirje të gjerë institucionale dhe numër të konsiderueshëm përdoruesish. Të paktën tri prej tyre (iPacienti.com, B2B Farmaceutik, Pathfinder) e kalojnë çdo prag sasior që mund të nënkuptohet në mënyrë të arsyeshme nga togfjalëshi "numër i madh përdoruesish", edhe në mungesë të një pragu të shprehur numerikisht në DT.

Nga dokumentacioni i vendimeve (letrat B42 dhe vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim), konstatohet se AK-ja nuk ka dhënë asnjë analizë individuale për asnjërën nga këto pesë referenca, duke u mjaftuar me konstatim të përgjithshëm se përvoja e propozuar "nuk janë projekte të teknologjisë informative, të implementuara në nivel organizatash apo institucionesh me numër të madh përdoruesish dhe përdorim të gjerë", pa identifikuar cila referencë specifike nuk përmbush kriterin dhe pse.

Prandaj, meqë (a) DT nuk përcakton prag numerik konkret krahasues, dhe (b) dokumentacioni i dorëzuar dëshmon nivele domethënëse përdorimi për secilin nga pesë projektet, të analizuar individualisht, eksperti teknik mendon se pretendimi ankimor i OE në këtë pjesë është i bazuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet janë pjesërisht të bazuar por të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimmarrjen e AK. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara por që nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktiviteti i prokurimit të nënshtrohet rivelesimit.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovet pjesërisht si e bazuar dhe të mbetet në

fuqi njoftimi për dhënie të Autoritetit Kontraktues AQP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - Agjencia Qendrore e Prokrimit**
- **OE - Tretëk SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: